



**Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Drejtoria e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

“TEKNOLOGJIA BUJQËSORE”

Niveli IV në KSHK¹, referuar nivelit IV të KEK²

H10-IV-25

Tiranë, 2025

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Përmbajtje

Emërtimi i kualifikimit	4
Kodi.....	4
Kohëzgjatja	4
Niveli.....	4
Qëllimi.....	4
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	4
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	4
Ofruesit	4
Data e validimit	4
Data e miratimit	4
Variantet e mëparshme	4
Struktura e kualifikimit	5
Kompetenca të përgjithshme (qëndrimet)	5
NJËSITË E TË NXËNIT TË KUALIFIKIMIT PROFESIONAL	5
NjN-08-IV-0217-25 Planifikimi dhe organizimi i punës në teknologjitë bujqësore	5
Rezultatet e të nxënit në njohuri	5
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	7
Kriteret e vlerësimit	7
NjN-08-IV-0218-25 Mjetet motorike	8
Rezultatet e të nxënit në njohuri	8
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	8
Kriteret e vlerësimit	8
NjN-08-IV-0219-25 Mjetet/makinat bujqësore për përgatitjen e tokës për mbjellje	9
Rezultatet e të nxënit në njohuri	9
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	10
Kriteret e vlerësimit	10
NjN-08-IV-0220-25 Mjetet/makinat bujqësore për mbjellje dhe shërbimet kulturore (plehërim, trajtim fitosanitar, ujitje, etj.).....	11
Rezultatet e të nxënit në njohuri	11
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	12
Kriteret e vlerësimit	12

NjN-08-IV-0221-25 Mjetet/makineritë e korrjes, vjeljes dhe shkuljes së prodhimeve bujqësore	13
Rezultatet e të nxënit në njohuri	13
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	14
Kriteret e vlerësimit	14
NjN-08-IV-0222-25 Mjetet, pajisjet dhe makineritë për transportin, magazinimin, manipulimin dhe ruajtjen e prodhimeve bujqësore	15
Rezultatet e të nxënit në njohuri	15
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	16
Kriteret e vlerësimit	17
NjN-08-IV-0223-25 Mjetet e mekanizuara për shërbimet bazë blegtorale	18
Rezultatet e të nxënit në njohuri	18
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	18
Kriteret e vlerësimit	18
NjN-08-IV-0224-25 Mbikëqyrja e zbatimit të rregullave të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit në teknologjitë bujqësore.....	19
Rezultatet e të nxënit në njohuri	19
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	20
Kriteret e vlerësimit	20
NjN-23-IV-0005-24 Sipërmarrje dhe edukim karriere.....	21
Rezultatet e të nxënit në njohuri	21
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	21
Kritere vlerësimi	22
NjN-22-IV-0006-24 Komunikimi dhe etika profesionale	22
Rezultatet e të nxënit në njohuri	22
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	23
Kritere vlerësimi	23
Njësitë e të nxënit, peshat dhe kodet përkatëse:	23
Modalitetet e vlerësimit.....	24
Informacion shtesë	24
SHËNIM.....	25

Emërtimi i kualifikimit	Teknologjia bujqësore			Kodi
	Kohëzgjatja:	Niveli	Niveli IV KSHK, referuar nivelit IV të KEK	
	3000 orë nocionale		Niveli IV KSHK, referuar nivelit IV të KEK	H10-IV-25
Qëllimi:	Qëllimi kryesor i kualifikimit profesional “ Teknologjia bujqësore ”, niveli IV në KSHK , referuar nivelit IV të KEK, është përgatitja e individëve për t’u punësuar si teknik apo menaxher të mesëm në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me fushën e mekanizimit të bujqësisë dhe zhvillimi i personalitetit të individëve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon.			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	Në institucionet që ofrohet kualifikimi profesional “ Teknologjia bujqësore ”, niveli IV në KSHK , referuar nivelit IV të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë individët që: <ul style="list-style-type: none"> – kanë mbaruar dy vitet e para në arsimin profesional në kualifikimin profesional “Bujqësi”, niveli II KSHK, referuar nivelit II të KEK; – janë në kushtet shëndetësore të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional; – pranohen edhe individë që kanë aftësi ndryshe, për të cilët ofruesi i kualifikimit krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me aftësitë që shfaqin. 			
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “ Teknologjia bujqësore ”, niveli IV në KSHK , referuar nivelit IV të KEK e pajis individin me Certifikatën Profesionale dhe Supplementin përkatës të këtij niveli, si teknik i mesëm në këtë kualifikim profesional, e cila njihet në territorin e Republikës së Shqipërisë. Ky arsimim i jep mundësi individit t’i drejtohet tregut të punës për t’u punësuar në ferma bujqësore dhe blegtorale, në parqe të makinerive bujqësore, në pikat e shitjes së makinerive bujqësore/blegtorale dhe pikat e servisit të makinerive bujqësore. Gjithashtu, individi mund të vetëpunësohet në kuadrin e një biznesi individual në fushën e mekanizimit në bujqësi. Me përfundimin e këtij niveli, individi ka mundësi për të fituar të drejtën e Diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve në nivelin V ose nivelin VI të KSHK referuar nivelit V dhe VI të KEK.			
Ofruesit	Ky kualifikim duhet të ofrohet nga ofrues të akredituar në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi për arsimin dhe formimin profesional.			
Data e validimit	2025			
Data e miratimit				
Variantet e mëparshme	H10-IV-20			

Struktura e kualifikimit profesional

Në përfundim të kualifikimit profesional “**Teknologji bujqësore**” niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, individi do të zotërojë njohuritë profesionale të ndara sipas njësive të të nxënit të mëposhtme:

Kompetenca të përgjithshme (qëndrimet)

Rezultatet e të nxënit të kompetencave të përgjithshme janë të vlefshme për të gjitha njësitë e të nxënit.

1. Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme;
2. Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional;
3. Të nxisë potencialin e tij/saj të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente;
4. Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
5. Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale;
6. Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij/saj;
7. Të organizojë drejt procesin e të nxënit të tij/saj dhe të shfaqë gatishmëri dhe vullnet për të nxënë gjatë gjithë jetës;
8. Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar;
9. Të demonstrojë aftësi për të përmbushur detyrat brenda afateve sipas një plani të caktuar;
10. Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij;
11. Të marrë nisma për të bashkëpunuar me individë apo grupe;
12. Të demonstrojë sjellje të përgjegjshme dhe etike në veprimtari shkollore dhe komunitet;
13. Të demonstrojë aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe për qenë pjesëmarrës pro aktiv në grup;
14. Të pranojë dhe të promovojë risitë dhe ndryshimet;
15. Të vlerësojë dhe vetëvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij, për t'u përshtatur me evolucionin teknologjik.

NJËSITË E TË NXËNIT TË KUALIFIKIMIT PROFESIONAL:

Standardet e kualifikimit hartohen në bazë të rezultateve të të nxënit (kompetenca të përgjithshme, njohuri dhe shprehje profesionale).

NjN-08-IV-0217-25 Planifikimi dhe organizimi i punës në teknologjitë bujqësore

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë legjislacionin bazë në fushën e bujqësisë;
2. Të shpjegojë kuptimin e së drejtës agrare, raportin e saj me degët e tjera të së drejtës;
3. Të shpjegojë ç'është prona dhe elementët e së drejtës së pronësisë;
4. Të listojë disa standarde që veprojnë në sektorin bujqësor;
5. Të interpretojë parimet e përgjithshme të legjislacionit kombëtar për rregullimin e territorit në përgjithësi dhe atij për mbrojtjen e tokës në veçanti;
6. Të shpjegojë legjislacionin bazë për përdorimin e inputeve bujqësore;
7. Të përshkruajë rëndësinë dhe mënyrën e organizimit të punës në fermë, si një element mjaft i rëndësishëm i menaxhimit të fermës;
8. Të shpjegojë format e ndryshme të organizimit të fermës dhe rolin e tyre në ekonominë e vendit;
9. Të listojë faktorët që ndikojnë në organizimin e punës dhe ndikimin e tyre në suksesin e fermës;
10. Të analizojë rubrikat e një plani prodhimi bujqësor;
11. Të shpjegojë teknologjitë e kultivimit të kulturave bujqësore;
12. Të shpjegojë rolin e bujqësisë së qëndrueshme në zhvillimin ekonomik të vendit;
13. Të klasifikojë tipet e mjeteve/makinave bujqësore sipas kërkesave të proceseve të punës;
14. Të identifikojë prioritetet e proceseve të punës ditore;
15. Të shpjegojë mënyrat e planifikimit të mjeteve/makinave dhe tipet përkatëse për realizimin e proceseve të punës (përgatitja e tokës, mbjellja, shërbimet kulturore, korrja/vjelja, transporti dhe magazinimi i prodhimeve bujqësore);
16. Të shpjegojë mënyrat e planifikimit të kohës së përdorimit të mjeteve/makinave sipas proceseve të punës;
17. Të shpjegojë mënyrat e planifikimit të burimeve (financiare, materiale dhe njerëzore);
18. Të shpjegojë kriteret e përzgjedhjes së mjeteve/makinave të nevojshme për çdo proces;
19. Të shpjegojë mënyrat e kontrollit të gatishmërisë për punë të mjeteve dhe pajisjeve të punës;
20. Të shpjegojë mënyrat e menaxhimit të burimeve të nevojshme (njerëzore, financiare dhe materiale) për kryerjen e proceseve të punës;
21. Të shpjegojë metodat e përzgjedhjes dhe ndarjes së detyrave sipas kualifikimeve përkatëse;
22. Të shpjegojë mënyrat e menaxhimit të mjeteve, makinerive dhe/ose pajisjeve të punës;
23. Të diskutojë mënyrat e sigurimit të makinerive bujqësore në fermë: pronësi ose marrja me qira e tyre;
24. Të analizojë rëndësinë e vlerësimit të performancës dhe motivimit të burimeve njerëzore;
25. Të tregojë mënyrat e evidentimit dhe raportimeve për veprimtarinë e kryer;
26. Të shpjegojë rëndësinë e përditësimit të informacionit me teknologjitë e reja bujqësore dhe platformave digjitale;
27. Të listojë mjetet dhe pajisjet e punës për mirëmbajtje dhe riparime;
28. Të përshkruajë mënyrat e pastrimit dhe sistemimit të vendit të punës;

29. Të argumentojë rëndësinë dhe mënyrat e bashkëpunimit me eprorin dhe specialistë të tjerë;
30. Të përshkruajë format e organizimit të vendit të punës në mënyrë ergonomike;
31. Të listojë llojet e dokumentacionit përkatës në funksion të organizimit të punës (urdhër pune, procesverbale të fillimit dhe mbarimit të punës etj.).

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të hartojë planin e veprimtarive sipas proceseve të teknologjive bujqësore;
2. Të organizojë punën për realizimin e veprimtarive;
3. Të menaxhojë burimet e nevojshme për realizimin e proceseve të punës;
4. Të dokumentojë dhe raportojë realizimin e detyrave sipas procedurave;
5. Të përzgjedhë makineritë bujqësore sipas procesit të punës që do të kryejë;
6. Të zbatojë kartat teknologjike sipas kulturave bujqësore;
7. Të përzgjedhë bazën e nevojshme materiale sipas kartave teknologjike.

Kriteret e vlerësimit

- Planifikon veprimtaritë ditore, javore dhe mujore sipas objektivave të prodhimit;
- Planifikon proceset e punës sipas kulturave dhe kalendarit të punimeve;
- Planifikon kohën dhe radhën e punës sipas llojit të kulturave bujqësore;
- Planifikon materialet, mjetet dhe pajisjet e punës sipas proceseve të punës;
- Planifikon burimet njerëzore dhe financiare sipas proceseve të punës;
- Vendos prioritetet e ditës sipas proceseve të punës që do të kryejë;
- Organizon punën në fermë sipas aktivitetit të planifikuar;
- Përcakton detyrat dhe prioritetet e një plani prodhimi ditor, javor dhe mujor sipas objektivave;
- Organizon vendin e punës në mënyrë ergonomike;
- Përzgjedh mjetet/makinat, sipas tipit për procesin e punës dhe madhësisë së fermës;
- Përzgjedh materialet dhe pajisjet e punës, sipas funksionit;
- Kontrollon gatishmërinë për punë të mjeteve dhe pajisjeve, sipas manualeve;
- Mbikëqyr pastrimin dhe sistemimin e vendit të punës sipas instruksioneve përkatëse;
- Zbaton rregullat e higjienës së vendit të punës, sipas standardeve;
- Përzgjedh burimet e nevojshme njerëzore sipas proceseve të punës dhe kualifikimit përkatës të tyre;
- Koordinon bashkëpunimin me eprorët dhe specialistë të tjerë, sipas rregullores së brendshme;
- Dokumenton në mënyrë periodike punën e kryer, sipas formateve përkatëse dhe legjislacionit përkatës;
- Raporton në mënyrë periodike për realizimin e detyrave, sipas formateve përkatëse.

NjN-08-IV-0218-25 Mjetet motorike

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të listojë llojet e mjeteve motorike që përdoren në fushën e bujqësisë;
2. Të listojë llojet e karburanteve dhe lubrifikantëve që përdoren në mjetet motorike;
3. Të shpjegojë ndërtimin, funksionimin dhe përdorimin e motorit me djegie të brendshme;
4. Të shpjegojë ndërtimin, funksionimin dhe përdorimin e traktorit bujqësor;
5. Të shpjegojë ndërtimin, funksionimin dhe përdorimin e motokultivatorit;
6. Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit paraprak të mjeteve motorike;
7. Të listojë pajisjet e lidhjes së mjetit motorik me makinat bujqësore;
8. Të shpjegojë ndërtimin, funksionimin dhe përdorimin e pajisjeve lidhëse të mjetit motorik me makinat/pajisjet e punës në bujqësi;
9. Të shpjegojë domosdoshmërinë e zbatimit të manualit të përdorimit të mjeteve motorike;
10. Të përshkruajë mënyrat e sigurimit të mjetit motorik në shërbimet teknike ditore;
11. Të përshkruajë shërbimet teknike ditore të nevojshme të mjetit motorik;
12. Të listojë defektet e mundshme të mjeteve motorike;
13. Të përshkruajë riparimet e thjeshta në mjetet motorike;
14. Të përshkruajë shërbimet për mirëmbajtjen e mjeteve motorike;
15. Të përshkruajë rregullat e qarkullimit rrugor.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të identifikojë llojet e mjeteve motorike në fushën e bujqësisë në funksion të procesit teknologjik dhe tipit të fermës bujqësore;
2. Të kryejë kontrollin e gjendjes teknike të mjetit motorik para procesit të punës;
3. Të përdorë mjetin motorik në përputhje me procesin teknologjik dhe kushtet e punës;
4. Të kryejë identifikimin, vlerësimin dhe riparimin e defekteve të mundshme të mjeteve motorike;
5. Të zbatojë në mënyrë korrekte rregulloren e sigurimit teknik dhe qarkullimit rrugor.

Kriteret e vlerësimit

- Përzgjedh mjetin motorik në funksion të procesit teknologjik dhe tipit të fermës;
- Përzgjedh karburantin/lubrifikantin në funksion të tipit të motorit me djegie të brendshme;
- Kryen kontrollin paraprak të motorit me djegie të brendshme sipas manualit të përdorimit;
- Kryen kontrollin paraprak të traktorit sipas manualit të përdorimit;
- Kryen kontrollin paraprak të motokultivatorit sipas manualit të përdorimit;
- Kryen kontrollin paraprak të pajisjeve të punës së mjetit motorik, traktor/motokultivator, sipas manualit të përdorimit;
- Përdor traktorin bujqësor sipas manualit të përdorimit;
- Përdor motokultivatorin sipas manualit të përdorimit;

- Realizon lidhjen e mjetit motorik me makinat/pajisjet e punës në funksion të procesit teknologjik sipas manualit të përdorimit;
- Identifikon defektet e mjeteve motorik, sipas vlerësimit audio-vizual;
- Përcakton defektet e mjetit motorik sipas kontrollit teknik të drejtpërdrejtë;
- Përdor mjetet dhe pajisjet e punës për mirëmbajtje dhe riparime sipas manualeve përkatëse;
- Kryen riparime të thjeshta në mjetet motorike sipas llojit të defektit duke përdorur mjetet dhe pajisjet e duhura;
- Kryen shërbime ditore për mirëmbajtjen e mjetit motorik sipas manualit të përdorimit;
- Zbaton procedurat e sigurimit teknik të mjetit motorik sipas manualit të përdorimit të mjetit;
- Zbaton me korrektësi rregullat e qarkullimit rrugor.

NjN-08-IV-0219-25 Mjetet/makinat bujqësore për përgatitjen e tokës për mbjellje

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë proceset teknologjike të përgatitjes së tokës për mbjellje (sistemimi i tokave në fushë dhe tokat e pjerrëta, nivelimi sipërfaqësor i ngastrës, sistemi/sistemet e punimit të tokës etj.);
2. Të përshkruajë mënyrat e përgatitjes së tokës për mbjellje sipas kartave teknologjike të kulturave bujqësore;
3. Të shpjegojë konceptet, faktorët dhe nevojën e kullimit dhe ujitjes;
4. Të përshkruajë format dhe mënyrat e kullimit dhe ujitjes;
5. Të interpretojë normën agronomike të ujitjes;
6. Të vlerësojë treguesit më të rëndësishëm, të cilat përcaktojnë cilësinë e ujit për ujitje;
7. Të argumentojë domosdoshmërinë e mbikëqyrjes së cilësisë dhe mënyrave të ujitjes;
8. Të listojë mjetet/makinat për përgatitjen e tokës për mbjellje sipas kartave teknologjike;
9. Të përshkruajë ndërtimin, funksionimin dhe përdorimin e mjeteve/makinave për përgatitjen e tokës për mbjellje;
10. Të argumentojë rëndësinë e kontrollit paraprak të mjeteve/makinave për përgatitjen e tokës për mbjellje;
11. Të përshkruajë mënyrat e lidhjes së mjetit motorik me makinën/mjetin e punës për përgatitjen e tokës për mbjellje;
12. Të përshkruajë defektet e mundshme në mjetet/makinat për përgatitjen e tokës për mbjellje;
13. Të përshkruajë shërbimet bazë ditore në mjetet/makinat për përgatitjen e tokës për mbjellje;
14. Të shpjegojë domosdoshmërinë e zbatimit të manualit të përdorimit të mjeteve/makinave për përgatitjen e tokës për mbjellje;

15. Të shpjegojë procedurat e regjistrimit të mjeteve/makinave për përgatitjen e tokës për mbjellje dhe korrigjimeve të nevojshme sipas rastit;
16. Të shpjegojë metodat fushore të vlerësimit të cilësisë së përgatitjes së tokës për mbjellje;
17. Të argumentojë domosdoshmërinë e mbikëqyrjes së përgatitjes së tokës për mbjellje.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të përzgjedhë mjetet/makinat e përshtatshme për përgatitjen e tokës për mbjellje sipas kartës teknologjike;
2. Të kryejë kontrollin paraprak të gjendjes teknike të mjeteve/makinave për përgatitjen e tokës për mbjellje;
3. Të përdorë mjetet/makinat për përgatitjen e tokës për mbjellje sipas kartës teknologjike;
4. Të përzgjedhë mjetet/makinat për kullimin e parcelës/ngastrës;
5. Të regjistrojë mjetet/makinat për punimin e tokës sipas kartës teknologjike të kulturave bujqësore;
6. Të kryejë identifikimin, vlerësimin dhe riparimin e defekteve të mundshme në mjetet/makinat e përgatitjes së tokës për mbjellje;
7. Të kryejë shërbimet bazë ditore në mjetet/makinat për përgatitjen e tokës për mbjellje;
8. Të kryejë vlerësimin fushor të cilësisë së punës për përgatitjen e tokës për mbjellje.

Kriteret e vlerësimit

- Përzgjedh mjetet/makinat për sistemimin e tokës sipas gjendjes faktike të tokës dhe kulturës bujqësore;
- Përzgjedh mjetet/makinat për punimin e tokës sipas kulturave bujqësore;
- Përzgjedh mjetet/makinat për kullimin e tokës sipas gjendjes faktike të tokës dhe kulturës bujqësore;
- Kryen kontrollin paraprak të mjeteve/makinave të sistemimit të tokës sipas manualit të përdorimit të mjetit;
- Kryen kontrollin paraprak të mjeteve/makinave të punimit të tokës sipas manualit të përdorimit të mjetit;
- Kryen kontrollin paraprak të mjeteve/makinave për kullimin e tokës sipas manualit të përdorimit të mjetit;
- Regjistron mjetet/makinat për sistemimin e tokës sipas kartës teknologjike;
- Regjistron mjetet/makinat për punimin e tokës, sipas kartës teknologjike;
- Përdor mjetet/makinat për sistemimin e tokës sipas manualit të përdorimit të mjetit;
- Përdor plugun hapës të vijave kulluese të parcelës/ngastrës sipas manualit të përdorimit të mjetit dhe kartës teknologjike;
- Përdor mjetet/makinat për punimin e tokës sipas manualit të përdorimit të mjetit;
- Kryen korrigjimet e nevojshme të regjistrimit, gjatë procesit të punës, në funksion të cilësisë së punimeve;

- Identifikon defektet në mjetet/makinat për përgatitjen e tokës për mbjellje në mënyrë audio-vizuale;
- Kryen riparime të thjeshta në mjetet/makinat për përgatitjen e tokës për mbjellje sipas manualit të përdorimit duke përdorur mjetet dhe pajisjet e duhura;
- Kryen shërbimet ditore për mirëmbajtjen e mjeteve/makinave për përgatitjen e tokës për mbjellje sipas manualit të përdorimit;
- Kryen vlerësimin fushor të cilësisë së sistemimit dhe punimit të tokës sipas kartës teknologjike.

NjN-08-IV-0220-25 Mjetet/makinat bujqësore për mbjellje dhe shërbimet kulturore (plehërim, trajtim fitosanitar, ujitje, etj.)

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë procesin e mbjelljes së farave, fidanëve, bul, rizomë me mjete/makina bujqësore;
2. Të përshkruajë teknikat dhe mënyrat e mbjelljes së farave, fidanëve, bul, rizomë sipas kartës teknologjike;
3. Të interpretojë normat e farës sipas kartës teknologjike;
4. Të argumentojë afatet e mbjelljes së farave, fidanëve, bul, rizomë sipas kartës teknologjike;
5. Të listojë llojet e plehëruesve bimorë, karakteristikat fizike, mënyrat dhe kohën e përdorimit të tyre;
6. Të listojë llojet e sëmundjet dhe dëmtuesit kryesore të kulturave bujqësore;
7. Të listojë llojet e pesticideve, karakteristikat fizike, mënyrat dhe kohën e përdorimit, karencën e tyre, efektet negative në shëndet dhe mjedis etj.;
8. Të argumentojë specifikat e mjeteve/makinave për trajtimin fitosanitar të farave, fidanëve, bul, rizomë;
9. Të listojë mjetet makinat bujqësore për mbjelljen dhe shërbimet kulturore (plehërim, trajtim fitosanitar, ujitje etj.);
10. Të shpjegojë ndërtimin, funksionimin dhe përdorimin e mjeteve/makinave për mbjellje dhe shërbime kulturore;
11. Të argumentojë rëndësinë e kontrollit paraprak të makinave për mbjellje dhe shërbime kulturore;
12. Të përshkruajë mënyrat e lidhjes së mjeteve/makinave për mbjellje dhe shërbime kulturore me mjetin motorik;
13. Të listojë defektet e mundshme të mjeteve/makinave për mbjellje dhe shërbime kulturore;
14. Të përshkruajë shërbimet bazë të mjeteve/makinave për mbjellje dhe shërbime kulturore;
15. Të shpjegojë domosdoshmërinë e zbatimit të manualit të përdorimit të mjeteve/makinave për mbjellje dhe shërbime kulturore;

16. Të shpjegojë mënyrat e regjistrimit të mjeteve/makinave për mbjellje dhe shërbime kulturore dhe korigjimeve e nevojshme sipas rastit;
17. Të shpjegojë metodat e kontrollit të cilësisë së mbjelljes dhe shërbimeve kulturore;
18. Të argumentojë domosdoshmërinë e mbikëqyrjes së cilësisë së mbjelljes dhe shërbimeve kulturore;

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të përzgjedhë inputet e nevojshme për realizimin e proceseve teknologjike;
2. Të përzgjedhë mjetet/makinat e përshtatshme për mbjelljen e kulturave bujqësore;
3. Të kryejë kontrollin paraprak të gjendjes teknike të mjeteve/makinave për mbjellje;
4. Të regjistrojë mjetet/makinat bujqësore sipas kartës teknologjike;
5. Të përdorë mjetet/makinat mbjellëse sipas kartës teknologjike;
6. Të përzgjedhë mjetet/makinat për shërbime kulturore (plehërim, trajtim fitosanitar, ujitje etj.);
7. Të kryejë kontrollin paraprak të gjendjes teknike të mjeteve/makinave për shërbime kulturore;
8. Të regjistrojë mjetet/makinat bujqësore për shërbimet kulturore sipas kartës teknologjike;
9. Të përdorë mjetet/makinat bujqësore për shërbimet kulturore sipas kartës teknologjike;
10. Të kryejë identifikimin, vlerësimin dhe riparimin e defekteve të mundshme të mjeteve/makinave për mbjellje dhe shërbimet kulturore;
11. Të kryejë shërbime bazë ditore në mjetet/makinat për mbjellje dhe shërbimet kulturore;
12. Të kryejë vlerësime të cilësisë së punës për mbjelljen dhe shërbimet kulturore;

Kriteret e vlerësimit

- Përzgjedh farat, fidanët bulb dhe rizomë për mbjelljen e kulturave bujqësore sipas kartës teknologjike;
- Përzgjedh mjetet/makinat për mbjelljen e kulturave bujqësore sipas kartës teknologjike;
- Përzgjedh plehrat/fertilizues sipas kulturave bujqësore dhe kartës teknologjike;
- Përzgjedh mjetet/makinat bujqësore për plehërimin sipas llojit të plehrave dhe mënyrat e plehërimit të kulturave bujqësore;
- Përzgjedh pesticidet e duhura sipas shërbimeve fitosanitare, sipas kartës teknologjike;
- Përzgjedh mjetet/makinat bujqësore për shërbime fitosanitare sipas kartës teknologjike;
- Përzgjedh mjetet/makinat bujqësore për ujitjen e kulturave bujqësore sipas mënyrave dhe teknikave të ujitjes;
- Kryen kontrollin paraprak të mjeteve/makinat për mbjelljen e kulturave bujqësore sipas manualit të përdorimit;
- Kryen kontrollin paraprak të mjeteve/makinat bujqësore për plehërimin sipas manualit të përdorimit;
- Kryen kontrollin paraprak të mjeteve/makinat bujqësore për shërbime fitosanitare sipas manualit të përdorimit;

- Kryen kontrollin paraprak të mjeteve /makinave bujqësore për ujitjen e kulturave bujqësore sipas manualit të përdorimit;
- Regjistron makinat për mbjelljen e kulturave bujqësore sipas kartës teknologjike;
- Regjistron makinat për shpërndarjen e plehrave (të ngurtë, lëngët e të gaztë) sipas kartës teknologjike;
- Regjistron makinat e mbrojtjes së bimëve (trajtim fitosanitar) sipas kartës teknologjike;
- Regjistron makinat/impianetet ujitëse sipas kartës teknologjike;
- Përdor makinat mbjellëse për mbjelljen e kulturave bujqësore sipas manualit të përdorimit dhe kartës teknologjike;
- Përdor makinat plehëruese për plehërimin e bimëve sipas manualit të përdorimit dhe kartës teknologjike;
- Përdor makinat e mbrojtjes së bimëve për trajtim fitosanitar sipas manualit të përdorimit dhe kartës teknologjike;
- Përdor makinat ujitëse për ujitjen e bimëve sipas manualit të përdorimit dhe kartës teknologjike;
- Kryen korrigjimet e nevojshme të regjistrimit gjatë procesit të punës në funksion të cilësisë së punimeve;
- Identifikon defektet në mjetet/makinat për mbjellje dhe shërbime kulturore në mënyrë audio-vizuale;
- Kryen riparime të mjeteve/makinave për mbjellje dhe shërbime kulturore sipas manualit të përdorimit duke përdorur mjetet dhe pajisjet e duhura;
- Kryen shërbime të mjeteve/makinave për mbjellje dhe shërbime kulturore sipas manualit të shërbimeve;
- Kryen vlerësime të cilësisë së mbjelljes dhe shërbimeve kulturore sipas kartës teknologjike.

NjN-08-IV-0221-25 Mjetet/makineritë e korrjes, vjeljes dhe shkuljes së prodhimeve bujqësore

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë procesin e korrjes, vjeljes, shkuljes së prodhimeve bujqësore;
2. Të përshkruajë teknikat e korrjes, vjeljes, shkuljes së prodhimeve bujqësore;
3. Të argumentojë kohën e korrjes, vjeljes, shkuljes së prodhimeve bujqësore;
4. Të dallojë specifikat e mjeteve/makinerive/pajisjeve për korrjen, vjeljen, shkuljen e prodhimeve bujqësore;
5. Të listojë mjetet/makineritë/pajisjet për korrjen, vjeljen, shkuljen e prodhimeve bujqësore;
6. Të përshkruajë ndërtimin, funksionimin, përdorimin e mjeteve/makinerive për korrjen, vjeljen, shkuljen e prodhimeve bujqësore;
7. Të argumentojë rëndësinë e kontrollit paraprak të mjeteve/makinerive/pajisjeve për korrjen, vjeljen, shkuljen e prodhimeve bujqësore;

8. Të përshkruajë mënyrat e lidhjes së mjeteve/makinerive/pajisjeve për korrje, vjeljen, shkuljen e prodhimeve bujqësore me mjetin motorik;
9. Të listojë defektet e mundshme të mjeteve/makinerive/pajisjeve për korrje, vjelje, shkulje të prodhimeve bujqësore;
10. Të listojë shërbimet bazë të mjeteve/makinerive/pajisjeve për korrje, vjelje, shkulje të prodhimeve bujqësore;
11. Të argumentojë domosdoshmërinë e zbatimit të manualeve të përdorimit të mjeteve/makinerive/pajisjeve për korrje, vjelje, shkulje të prodhimeve bujqësore;
12. Të shpjegojë mënyrat e regjistrimit të mjeteve/makinerive/pajisjeve për korrje, vjelje, shkulje të prodhimeve bujqësore dhe korrigjimet e nevojshme sipas rastit;
13. Të shpjegojë metodat e kontrollit të cilësisë së punimeve sipas mjeteve/makinerive/pajisjeve për korrje, vjelje, shkulje të prodhimeve bujqësore.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të përzgjedhë mjetet/makineritë/pajisjet e përshtatshme për korrjen, vjeljen, shkuljen e prodhimeve bujqësore;
2. Të kryejë kontrollin paraprak të gjendjes teknike të mjeteve/makinerive/pajisjeve për korrjen, vjeljen, shkuljen e prodhimeve bujqësore;
3. Të regjistrojë mjetet/makineritë/ pajisjet për korrjen, vjeljen, shkuljen e prodhimeve bujqësore;
4. Të përdorë mjetet/makineritë/pajisjet për korrjen, vjeljen, shkuljen e prodhimeve bujqësore;
5. Të kryejë identifikimin, vlerësimin dhe riparimin e defekteve të mundshme të mjeteve/makinave/pajisjeve për korrjen, vjeljen, shkuljen e prodhimeve bujqësore;
6. Të kryejë shërbimet bazë ditore të mjeteve/makinave/pajisjeve për korrjen, vjeljen, shkuljen e prodhimeve bujqësore;
7. Të vlerësojë cilësinë e punës së mjeteve/makinave/pajisjeve për korrjen, vjeljen, shkuljen e prodhimeve bujqësore.

Kriteret e vlerësimit

- Përzgjedh mjetet/makinat/ pajisjet për korrjen e prodhimeve bujqësore sipas kartës teknologjike;
- Përzgjedh mjetet/makinat/pajisjet për vjeljen e prodhimeve bujqësore sipas kartës teknologjike;
- Përzgjedh mjetet/makinat/pajisjet për shkuljen e prodhimeve bujqësore sipas kartës teknologjike;
- Kryen kontrollin paraprak të mjeteve/makinave/ pajisjeve për korrjen e prodhimeve bujqësore sipas manualit të përdorimit;
- Kryen kontrollin paraprak të mjeteve/makinave/pajisjeve për vjeljen e prodhimeve bujqësore sipas manualit të përdorimit;

- Kryen kontrollin paraprak të mjeteve/makinave/pajisjeve për shkulljen e prodhimeve bujqësore sipas manualit të përdorimit;
- Regjistron mjetet/makinat/pajisjet për korrjen e prodhimeve bujqësore sipas kartës teknologjike dhe manualit të përdorimit;
- Regjistron mjetet/makinat/pajisjet për vjeljen e prodhimeve bujqësore sipas kartës teknologjike dhe manualit të përdorimit;
- Regjistron mjetet/makinat/pajisjet për shkulljen e prodhimeve bujqësore sipas kartës teknologjike dhe manualit të përdorimit;
- Përdor mjetet/makinat/pajisjet për korrjen e prodhimeve bujqësore sipas manualit të përdorimit;
- Përdor mjetet/makinat/pajisjet për vjeljen e prodhimeve bujqësore sipas manualit të përdorimit;
- Përdor mjetet/makinat/pajisjet për shkulljen e prodhimeve bujqësore sipas manualit të përdorimit;
- Kryen korrjimet e nevojshme të regjistrimit gjatë procesit të punës në funksion të cilësisë së punimeve;
- Identifikon defektet në mjetet/makinat/pajisjet për korrjen, vjeljen, shkulljen e prodhimeve bujqësore në mënyrë audio-vizuale;
- Kryen riparime të thjeshta të mjeteve/makinave/pajisjeve për korrjen, vjeljen, shkulljen e prodhimeve bujqësore sipas manualit të përdorimit duke përdorur mjetet dhe pajisjet e duhura;
- Kryen shërbime ditore të mjeteve/makinave/pajisjeve për korrjen, vjeljen, shkulljen e prodhimeve bujqësore sipas manualit të shërbimit;
- Mbikëqyr cilësinë e punës me mjete/makina/pajisje për korrjen, vjeljen, shkulljen e prodhimeve bujqësore sipas kartës teknologjike.

NjN-08-IV-0222-25 Mjetet, pajisjet dhe makineritë për transportin, magazinimin, manipulimin dhe ruajtjen e prodhimeve bujqësore

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të argumentojë rëndësinë e transportit, magazinimit, manipulimit dhe ruajtjes së prodhimeve bujqësore;
2. Të përshkruajë teknikat dhe mënyrat e transportit të prodhimeve bujqësore;
3. Të përshkruajë mënyrat e magazinimit, manipulimit dhe ruajtjes së prodhimeve bujqësore;
4. Të argumentojë kohën optimale për transportin, magazinimin, manipulimin dhe ruajtjen e prodhimeve bujqësore;
5. Të argumentojë rëndësinë e faktorëve klimatike gjatë proceseve të transportit, magazinimit, manipulimit dhe ruajtjes së prodhimeve bujqësore;
6. Të listojë mjetet/makineritë/pajisjet për transportin, magazinimin, manipulimin dhe ruajtjen e prodhimeve bujqësore;

7. Të listojë specifikat e mjeteve/makinerive/pajisjeve për transportin, magazinimin, manipulimin dhe ruajtjes së prodhimeve bujqësore;
8. Të përshkruajë ndërtimin, funksionimin dhe përdorimin e mjeteve/makinerive/pajisjeve për transportin, magazinimin, manipulimin dhe ruajtjen e prodhimeve bujqësore;
9. Të argumentojë rëndësinë e kontrollit paraprak të mjeteve/makinerive/pajisjeve për transportin, magazinimin, manipulimin dhe ruajtjen e prodhimeve bujqësore;
10. Të përshkruajë mënyrat e lidhjes së mjeteve/makinerive/pajisjeve për transportin, magazinimin, manipulimin dhe ruajtjen e prodhimeve bujqësore me mjetin motorik;
11. Të përshkruajë burimet e energjisë për mjetet/makineritë/pajisjet për transportin, magazinimin, manipulimin dhe ruajtjen e prodhimeve bujqësore sipas manualit të përdorimit;
12. Të listojë defektet e mundshme të mjeteve/makinerive/pajisjeve për transportin, magazinimin, manipulimin dhe ruajtjes së prodhimeve bujqësore;
13. Të përshkruajë shërbimet bazë të mjeteve/makinerive/pajisjeve për transportin, magazinimin, manipulimin dhe ruajtjes së prodhimeve bujqësore;
14. Të argumentojë domosdoshmërinë e zbatimit të manualeve të përdorimit të mjeteve/makinerive/pajisjeve për transportin, magazinimin, manipulimin dhe ruajtjen e prodhimeve bujqësore;
15. Të shpjegojë mënyrat e regjistrimit të mjeteve/makinerive/pajisjeve për transportin, magazinimin, manipulimin dhe ruajtjen e prodhimeve bujqësore dhe korigjimeve e nevojshme sipas rastit;
16. Të shpjegojë metodat e kontrollit të cilësisë së punës së mjeteve/makinerive/pajisjeve për transportin, magazinimin, manipulimin dhe ruajtjen e prodhimeve bujqësore.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të përzgjedhë mjetet/makineritë/pajisjet e përshtatshme për transportin, magazinimin, manipulimin dhe ruajtjen e prodhimeve bujqësore;
2. Të kryejë kontrollin paraprak të gjendjes teknike të mjeteve/makinerive/pajisjeve për transportin, magazinimin, manipulimin dhe ruajtjen e prodhimeve bujqësore;
3. Të regjistrojë mjetet/makineritë/pajisjet për transportin, magazinimin, manipulimin dhe ruajtjen e prodhimeve bujqësore sipas kartës teknologjike;
4. Të përdorë mjetet/makineritë/pajisjet për transportin, magazinimin, manipulimin dhe ruajtjen e prodhimeve bujqësore sipas manualit të përdorimit;
5. Të kryejë identifikimin dhe riparimin e defekteve të thjeshta të mjeteve/makinerive/pajisjeve për transportin, magazinimin, manipulimin dhe ruajtjen e prodhimeve bujqësore;
6. Të kryejë shërbimet bazë ditore të mjeteve/makinerive/pajisjeve për transportin, magazinimin, manipulimin dhe ruajtjen e prodhimeve bujqësore;
7. Të vlerësojë cilësinë e punës së mjeteve/makinerive/pajisjeve për transportin, magazinimin, manipulimin dhe ruajtjen e prodhimeve bujqësore.

Kriteret e vlerësimit

- Përzgjedh mjetet/makineritë/pajisjet për transportin e prodhimeve bujqësore sipas llojit të produktit;
- Përzgjedh mjetet/makineritë/pajisjet për magazinimin dhe manipulimin e prodhimeve bujqësore sipas llojit të produktit;
- Përzgjedh mjetet/makineritë/pajisjet për ruajtjen e prodhimeve bujqësore sipas llojit të produktit dhe protokollit përkatës;
- Kryen kontrollin paraprak të mjeteve/makinerive/pajisjeve për transportimin e prodhimeve bujqësore sipas manualit të përdorimit;
- Kryen kontrollin paraprak të mjeteve/makinerive/pajisjeve për magazinimin dhe manipulimin e prodhimeve bujqësore sipas manualit të përdorimit;
- Kryen kontrollin paraprak të mjeteve/makinerive/pajisjeve për ruajtjen e prodhimeve bujqësore sipas manualit të përdorimit;
- Regjistron mjetet/makineritë/pajisjet për transportin e prodhimeve bujqësore sipas manualit të përdorimit;
- Regjistron mjetet/makineritë/pajisjet për magazinimin dhe manipulimin e prodhimeve bujqësore sipas manualit të përdorimit;
- Regjistron mjetet/makineritë/pajisjet për ruajtjen e prodhimeve bujqësore, sipas manualit të përdorimit;
- Monitoron parametrat e punës së pajisjeve digjitale për ruajtjen e prodhimeve bujqësore sipas protokolleve përkatëse;
- Përdor mjetet/makineritë/pajisjet për transportin e prodhimeve bujqësore sipas manualit të përdorimit;
- Përdor mjetet/makineritë/pajisjet për magazinimin dhe manipulimin e prodhimeve bujqësore sipas manualit të përdorimit;
- Përdor mjetet/makineritë/pajisjet për ruajtjen e prodhimeve bujqësore sipas manualit të përdorimit dhe protokolleve përkatëse;
- Përdor pajisje digjitale për ruajtjen e prodhimeve bujqësore sipas manualit të përdorimit;
- Kryen korrigjimet e nevojshme të regjistrimit gjatë procesit të punës në funksion të cilësisë;
- Identifikon defektet në mjetet/makineritë/pajisjet për transportin, magazinimin, manipulimin dhe ruajtjen e prodhimeve bujqësore në mënyrë audiovizuale;
- Kryen riparime të thjeshta të mjeteve/makinerive/pajisjeve për transportin, magazinimin, manipulimin dhe ruajtjen e prodhimeve bujqësore sipas manualit;
- Kryen shërbime periodike të mjeteve/makinerive/pajisjeve për transportin, magazinimin, manipulimin dhe ruajtjen e prodhimeve bujqësore sipas manualit të shërbimit;
- Vlerëson cilësinë e punës së mjeteve/makinerive/pajisjeve për transportin, magazinimin, manipulimin dhe ruajtjen e prodhimeve bujqësore sipas procesit dhe protokolleve përkatëse.

NjN-08-IV-0223-25 Mjetet e mekanizuara për shërbimet bazë blegtorale

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të listojë mjetet, pajisjet dhe makineritë për shërbimet bazë blegtorale;
2. Të shpjegojë ndërtimin, funksionimin dhe përdorimin e mjeteve, pajisjeve dhe makinerive për shërbimet bazë blegtorale;
3. Të përshkruajë mënyrat e vënies në punë të pajisjeve, mjeteve dhe makinerive për shërbimet bazë blegtorale;
4. Të argumentojë rëndësinë e manualeve të përdorimit të mjeteve, pajisjeve dhe makinerive për shërbimet bazë blegtorale;
5. Të listojë defektet e mundshme të mjeteve, pajisjeve dhe makinerive për shërbimet bazë blegtorale;
6. Të përshkruajë mënyrën e riparimeve të thjeshta të mjeteve, pajisjeve dhe makinerive për shërbimet bazë blegtorale.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të përzgjedhë mjetet/makinat e përshtatshme për shërbimet bazë blegtorale;
2. Të kryejë kontrollin paraprakë të gjendjes teknike të mjeteve/makinave për shërbimet bazë blegtorale;
3. Të regjistrojë mjetet/makinat për shërbimet bazë blegtorale;
4. Të përdorë mjetet/makinat për shërbimet bazë blegtorale;
5. Të kryejë identifikimin, vlerësimin dhe riparimin e defekteve të mundshme në mjetet/makinat për shërbimet bazë blegtorale;
6. Të kryejë shërbimet bazë ditore në mjetet/makinat për shërbimet bazë blegtorale;
7. Të kryejë kontrollin periodik të cilësisë së punës së mjeteve/makinave për shërbimet bazë blegtorale.

Kriteret e vlerësimit

- Përzgjedh mjetet/makinat për mjeljen sipas llojit të fermës blegtorale;
- Përzgjedh mjetet/makinat për shërbime në kafshët bujqësore sipas llojit të fermës blegtorale;
- Kryen kontrollin paraprak të mjeteve/makinave të mjeljes së kafshëve bujqësore sipas manualit të përdorimit dhe tipit të fermës blegtorale;
- Kryen kontrollin paraprak të mjeteve/makinave të shërbimit të kafshëve bujqësore sipas manualit të përdorimit të mjetit dhe tipit të fermës blegtorale;
- Kryen kontrollin paraprak të mjeteve/makinave, sistemeve për furnizimin me ujë të stallave sipas tipit të fermës blegtorale dhe manualit të përdorimit;
- Kryen kontrollin paraprak të mjeteve/makinave, sistemeve të ruajtjes së parametrave klimatikë të stallave sipas tipit të fermës blegtorale dhe manualit të përdorimit;
- Regjistron mjetet/makinat për mjeljen dhe shërbimet e kafshëve bujqësore sipas manualit të përdorimit;

- Regjistron sistemet e furnizimit me ujë dhe parametrave klimatikë në stallë, në funksion të fermës blegtorale;
- Përdor mjetet/makinat për mjeljen e kafshëve bujqësore sipas manualit të përdorimit;
- Përdor mjetet/makinat për shërbime në kafshët bujqësore sipas manualit të përdorimit të mjetit;
- Kontrollon dhe vlerëson parametrat e proceseve të automatizuara në fermat blegtorale sipas katalogëve udhëzues përkatës;
- Identifikon defektet në mjetet/makinat për shërbimet bazë blegtorale në mënyrë audiovizuale;
- Kryen riparime të thjeshta në mjetet/makinat për shërbimet bazë blegtorale sipas manualit të përdorimit;
- Kryen shërbimet ditore për mirëmbajtjen e mjeteve/makinave për shërbimet bazë blegtorale sipas manualit të përdorimit;
- Kryen kontrollin periodik të mjeteve/makinave dhe sistemeve për shërbime bazë blegtorale sipas manualeve të përdorimit.

NjN-08-IV-0224-25 Mbikëqyrja e zbatimit të rregullave të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit në teknologjitë bujqësore

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë legjislacionin shqiptar për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë në punë të punonjësve;
2. Të përshkruajë faktorët që ndikojnë negativisht në shëndetin e punonjësve dhe masat që merren për evitimin e tyre;
3. Të listojë mjetet dhe pajisjet e mbrojtjes individuale dhe kolektive duke shpjeguar dhe përdorimet e tyre;
4. Të listojë llojet e mundshme të aksidenteve gjatë kryerjes së punimeve dhe shërbimeve në bujqësi, si dhe mënyrën e shmangies së tyre;
5. Të shpjegojë, për çdo post pune, rregullat e sigurimit teknik në punë;
6. Të argumentojë rëndësinë e afishimit të rregullave të sigurimit teknik në çdo post pune;
7. Të shpjegojë legjislacionin shqiptar të parandalimit, mbrojtjes, neutralizimit dhe shpëtimit ndaj fatkeqësive natyrore, zjarri etj., si dhe evakuimin e punonjësve;
8. Të përshkruajë procedurat standarde të evakuimit sipas rasteve të emergjencës;
9. Të shpjegojë pasojat e përdorimit të agregatit bujqësor nga persona të paautorizuar;
10. Të përshkruajë raste të aksidenteve që mund të ndodhin në fermat bujqësore e blegtorale dhe masat që merren për parandalimin e tyre;
11. Të përshkruajë veprimet e nevojshme për të dhënë ndihmën e parë për të dëmtuarin në punë;
12. Të përshkruajë karakteristikat e mjedisit të qëndrueshëm;
13. Të përshkruajë rregullat e mbrojtjes së mjedisit për ndarjen e mbetjeve sipas llojit;
14. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të rregulloreve përkatëse për depozitimin e mbetjeve;

15. Të përshkruajë rregullat e sigurisë për ruajtjen dhe magazinimin e materialeve që rrezikojnë ndotjen e mjedisit;
16. Të shpjegojë shkaqet dhe rreziqet kryesore të ndotjes së mjedisit nga mbetjet bujqësore dhe blegtorale;
17. Të shpjegojë mënyrat e asgjësimit të mbetjeve;
18. Të përshkruajë masat që duhen marrë dhe pajisjet e nevojshme për të minimizuar efektet e dëmshme të mbetjeve bujqësore e blegtorale;
19. Të përshkruajë protokollat e duhura në rastet e gjendjeve të jashtëzakonshme.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të zbatojë rregullat për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurinë në punë;
2. Të japë ndihmën e parë në rast aksidenti;
3. Të zbatojë rregullat e mbrojtjes së mjedisit.

Kriteret e vlerësimit

- Zbaton legjislacionin shqiptar për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurinë në punë të punonjësve;
- Evidenton faktorët që ndikojnë negativisht në shëndetin e punonjësve dhe masat që merren për evitimin e tyre;
- Përdor mjetet dhe pajisjet e mbrojtjes individuale në punë gjatë kryerjes së punimeve dhe shërbimeve në bujqësi;
- Evidenton shkaqet e aksidenteve gjatë kryerjes së punimeve dhe shërbimeve në fermë, si dhe mënyrën e shmangies së tyre;
- Zbaton rregullat e sigurimit teknik gjatë kryerjes së punimeve dhe shërbimeve në fermë;
- Krijon këndin e afishimit të rregullave të sigurimit teknik në çdo post pune në fermë;
- Zbaton legjislacionin shqiptar të parandalimit, mbrojtjes, neutralizimit dhe shpëtimit ndaj fatkeqësive natyrore, zjarrit, përmytjeve etj., si dhe evakuimin e punonjësve, sipas protokolleve dhe udhëzuesve përkatës;
- Kryen veprimet e nevojshme për të dhënë ndihmën e parë për të dëmtuarin në punë sipas protokolleve përkatëse;
- Përdor pajisjet mbrojtëse kundër zjarrit, sipas manualeve përkatëse;
- Zbaton procedurat standarde të evakuimit sipas rasteve të emergjencës;
- Zbaton rregulloret e monitorimit të burimeve mjedisore;
- Evidenton rreziqet kryesore të ndotjes së mjedisit nga mbetjet bujqësore e blegtorale, sipas protokolleve;
- Përdor pajisjet e nevojshme për minimizimin e efekteve të dëmshme të mbetjeve bujqësore e blegtorale sipas rastit;
- Mbikëqyr klasifikimin e mbetjeve sipas llojeve;
- Mbikëqyr depozitimin e mbetjeve sipas vendgrumbullimeve të lejuara;
- Mbikëqyr asgjësimin e mbetjeve sipas procedurave të paracaktuara;

- Mbikëqyr trajtimin e mbetjeve bujqësore dhe blegtorale për një zhvillim të qëndrueshëm sipas legjislacionit përkatës;
- Mbikëqyr zbatimin e rregullave të sigurimit teknik gjatë përdorimit të pesticideve, sipas standardeve;
- Ndalon përdorimin nga persona të paautorizuar të agregatit bujqësor;
- Respekton procedura standarde të sigurisë sipas rregullores përkatëse gjatë përdorimit të makinave bujqësore.

NjN-23-IV-0005-24 Sipërmarrje dhe edukim karriere

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të legjislacionit tatimor dhe kodin e punës në fuqi;
2. Të përshkruajë llojet e dokumentacioneve administrative dhe ekonomike në fushën e bujqësisë, si dhe rëndësinë e përpilimit dhe arkivimit të tyre;
3. Të interpretojë planet ditore, javore, mujore të punës, në përputhje me detyrat;
4. Të shpjegojë rëndësinë e informimit për çmimet, cilësinë e mjeteve dhe materialeve të punës për teknologjitë bujqësore;
5. Të përshkruajë elementët e llogaritjes së kostos/çmimit të punës dhe shërbimeve në teknologjitë bujqësore;
6. Të përshkruajë llojet e faturave dhe mënyrën e plotësimit të tyre;
7. Të përshkruajë mënyrat e përgatitjes së një oferte për shërbimin që do të ofrojë në realizimin e teknologjive bujqësore;
8. Të përshkruajë llojet dhe mënyrat e përgatitjes së dokumenteve për shërbimet e teknologjive bujqësore;
9. Të përshkruajë kushtet paraprake, procedurat për fillimin e një biznesi dhe regjistrimin e tij në fushën e bujqësisë;
10. Të përshkruajë mundësitë e ndryshme të financimit dhe investimit në fushën e bujqësisë;
11. Të përshkruajë teknikat e marketingut për shërbimet e teknologjive bujqësore;
12. Të përshkruajë rolin e bashkëpunëtorëve në veprimtarinë profesionale dhe parimet e punës në grup;
13. Të listojë llojet e trajnimeve dhe kurseve profesionale në zhvillimin profesional dhe në karrierë;
14. Të përshkruajë mënyrat e transmetimit të njohurive dhe aplikimin e teknikave të reja në punë tek bashkëpunëtorët;
15. Të shpjegojë domosdoshmërinë e pjesëmarrjes në panairë dhe ekspozita për teknologjitë bujqësore.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të zbatojë legjislacionin tatimor dhe kodin e punës në fuqi;
2. Të zbatojë detyrat administrative dhe tregtare;
3. Të zbatojë procedurat e sipërmarrjes për teknologjitë bujqësore;

4. Të zbatojë teknikat e marketingut në fushën e bujqësisë;
5. Të marrë nisma për zhvillimin profesional në teknologjitë bujqësore.

Kriteret e vlerësimit

1. Zbaton legjislacionin tatimor, kodin e punës dhe legjislacionin e lidhur me aktivitetin që kryen;
2. Harton një plan të thjeshtë biznesi, sipas specifikave përkatëse;
3. Plotëson planet periodike të punës, në përputhje me detyrat;
4. Zbaton kushtet paraprake dhe procedurat për fillimin e një biznesi në fushën e bujqësisë, sipas legjislacionit në fuqi;
5. Zbaton teknikat e duhura të marketingut në fushën e bujqësisë;
6. Merr periodikisht informacionin nga tregu për çmimet dhe cilësinë e mjeteve, materialeve, pajisjeve dhe pjesëve të këmbimit për teknologjitë bujqësore;
7. Përgatit oferta për shërbimet që do të ofrojë sipas procesit teknologjik;
8. Kryen llogaritje të kostos së punës dhe shërbimeve të kryera në bazë të detyrës së dhënë;
9. Llogarit çmimin përfundimtar për shërbimet e ofruara sipas rregullave referuar çmimeve të tregut;
10. Bashkëpunon me institucione financiare, sipas legjislacionit dhe nevojës;
11. Plotëson lloje të ndryshme të faturave, sipas shërbimit që do të ofrojë;
12. Harton, ruan dhe arkivon raportet ditore, javore, mujore të punës, sipas rregullores së brendshme;
13. Shkëmben udhëzime me bashkëpunëtorët për realizimin e detyrës së punës duke përdorur terminologji profesionale dhe të qartë në komunikim;
14. Vlerëson veten lidhur me mungesën e aftësive referuar proceseve të punës;
15. Ndjek trajnimet për ngritje profesionale dhe teknika të reja në punë, sipas teknologjisë bashkëkohore;
16. Transmeton njohuritë dhe teknikat e reja në punë tek bashkëpunëtorët sipas procesit të punës;
17. Merr pjesë rregullisht në panairë dhe ekspozita për teknologjitë e reja bujqësore.

NjN-22-IV-0006-24 Komunikimi dhe etika profesionale

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë rregullat bazë të komunikimit verbal dhe jo verbal sipas kodit të etikës;
2. Të shpjegojë rëndësinë e njohjes së kodit të etikës;
3. Të përshkruajë parimet e punës në grup;
4. Të shpjegojë rëndësinë e rregullave të mirësjelljes në bashkëbisedim;
5. Të shpjegojë rëndësinë e informimit të vazhdueshëm mbi problemet dhe të rejat e ditës;
6. Të përkufizojë terminologjinë e nevojshme profesionale gjatë kryerjes së punës;
7. Të shpjegojë rëndësinë e teknologjive bashkëkohore të informacionit dhe komunikimit;
8. Të shpjegojë rëndësinë e njohjes së rregullores së sipërmarrjes;

9. Të përshkruajë rregullat e raportimit sipas hierarkisë profesionale;
10. Të vlerësojë rëndësinë e bashkëpunësorëve dhe rolin e tyre në veprimtarinë profesionale;
11. Të përshkruajë metodat e zgjidhjes së ankesave dhe mosmarrëveshjeve me klientët;
12. Të shpjegojë parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikim;

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të respektojë kodin e etikës dhe rregullat e hierarkisë profesionale në komunikimin me eprorët dhe kolegët;
2. Të zbatojë rregullat bazë të komunikimit duke përdorur terminologji profesionale;
3. Të bashkëpunojë me të tjerë duke zbatuar parimet e punës në grup.

Kriteret e vlerësimit

- Zbaton parimet e etikës profesionale, sipas standardit;
- Zbaton rregullat e mirësjelljes në komunikimin verbal dhe jo verbal;
- Zbaton rregullat e hierarkisë në komunikimin me eprorët dhe kolegët, sipas rregullores së brendshme;
- Dëgjon në mënyrë aktive dhe të vëmendshme gjatë një bashkëbisedimi;
- Përdor rregullisht terminologjinë profesionale në komunikim;
- Komunikon/vepron në përputhje me parimet e barazisë gjinore, etnike, kombëtare, fetare dhe të tjera;
- Merr informacion të vazhdueshëm mbi problemet dhe të rejat e ditës, sipas nevojës;
- Përdor teknologjinë e informimit dhe komunikimit (TIK), sipas procedurave;
- Zbaton parimet e punës në grup;
- Zgjidh ankesat dhe mosmarrëveshjet me klientët, duke zbatuar teknikat përkatëse.

Njësitë e të nxënit, peshat dhe kodet përkatëse:

Nr.	Njësi të nxëni	Peshat në %	Kodet
1	Planifikimi dhe organizimi i punës në teknologjitë bujqësore	10	NjN-08-IV-0217-25
2	Mjetet motorike	12	NjN-08-IV-0218-25
3	Mjetet/makinat bujqësore për përgatitjen e tokës për mbjellje	12	NjN-08-IV-0219-25
4	Mjetet/makinat bujqësore për mbjellje dhe shërbimet kulturore (plehërim, trajtim fitosanitar, ujitje etj.)	12	NjN-08-IV-0220-25
5	Mjetet/makineritë e korrjes, vjeljes dhe shkuljes së prodhimeve bujqësore	12	NjN-08-IV-0221-25

6	Mjetet, pajisjet dhe makineritë për transportin, magazinimin, manipulimin dhe ruajtjen e prodhimeve bujqësore	10	NjN-08-IV-0222-25
7	Mjetet e mekanizuara për shërbimet bazë blegtorale	8	NjN-08-IV-0223-25
8	Mbikëqyrja e zbatimit të rregullave të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit në teknologjitë bujqësore	10	NjN-08-IV-0224-25
9	Sipërmarrje dhe edukim karriere	8	NjN-23-IV-0005-24
10	Komunikimi dhe etika profesionale	6	NjN-22-IV-0006-24
	Totali	100	

Modalitetet e vlerësimit

Me vlerësim kuptojmë procesin gjatë të cilit mblidhen të dhëna dhe gjykohet për vlerën e arritjes së një rezultati të nxëni (RN), mbi bazën e kritereve të caktuara.

Për vlerësimin mund të përdoren një shumëllojshmëri metodash standarde dhe inovatore.

Individi i nënshtrohet vlerësimit të vazhduar, përmbledhës dhe vlerësimit përfundimtar për kualifikimet formale që ofrohen në ofrues të akredituar.

Individi vlerësohet për shkallën e përvetësimit të kompetencave të përgjithshme dhe profesionale, të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën përkatëse dhe vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së RN për realizimin e tërësisë së proceseve duke mbajtur evidenca për qëllime dokumentimi.

Realizimi i pranueshëm do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të specifikuar.

Dhënia e rezultatit të vlerësimit bëhet sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Kompetencat e përgjithshme vlerësohen të integruara si pjesë e vlerësimit të njësive të të nxënit.

Individit i lind e drejta të certifikohet për njësitë të nxëni specifike, si një kualifikim i pjesshëm sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Informacion shtesë

Kualifikimet e plota ose të pjesshme profesionale mund të përftohen nëpërmjet këtyre formave:

- a) ndjekjes së arsimit profesional me bazë shkollën;
- b) ndjekjes së kurseve profesionale, ku përfshihen edhe praktikat profesionale në ndërmarrje apo forma të tjera të mësimnxënies praktike;
- c) regjistrimit si nxënës, duke u punësuar në një ndërmarrje (forma e dyfishtë);
- ç) njohjes të të nxënit të mëparshëm informal dhe joformal;
- d) njohjes të të nxënit të përfutur jashtë vendit;
- dh) formave të tjera të përcaktuara me ligj.

SHËNIM

Shpjegime të kodit të kualifikimit: **H10-IV-25**

H - Shkronja që identifikon fushën e kualifikimit profesional

10 - Numri që identifikon profilin/specializimin e kualifikimit përkatës

IV - Shifra që identifikon nivelin sipas KSHK-së

25 - Shkurtimi i vitit kalendarik kur është hartuar/rishikuar kualifikimi profesional

Shpjegime të kodit të njësisë së të nxënit: **NjN-08-IV-0217-25**

NjN - Shkronjat që tregojnë se kodi i referohet Njësive të të Nxënit

08 - Numri që identifikon fushën e Njësisë së të Nxënit

IV - Shifra që tregon nivelin e Njësisë së të Nxënit në strukturën e KSHK-së

0217 - Numri rritës progresiv që tregon gjendjen e Njësive të të Nxënit në ditën e hartimit përkatës

25 - Shkurtimi i vitit kalendarik kur është hartuar/rishikuar Njësia e të Nxënit